



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KAMËZ
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

Nr. 195 prot.

Kamëz, më 23.12.2020

V E N D I M

Nr. 168 . Datë 23.12.2020

P Ë R

MIRATIMIN E NJË SHTESE NË LISTËN VENDIMIT NR.149 DATË 07.12.2020 SË SUBJEKTEVE, TË CILËT PËRFITOJNË NGA GRANTET PËR RINDËRTIMIN E SHTËPIVE TË DËMTUARA NGA FATKEQËSIA NATYRORE E TËRMRTIT TË DATËS 26.NËNTOR 2019, VLERËSUAR SIPAS NIVELIT TË DËMTIMEVE NGA DS1-DS3 .

Këshilli Bashkiak Kamëz i mbledhur sot më 23.12.2020, në kushte të veçanta si pasojë e masave të ndërmarra për parandalimin e përhapjes së virusit COVID-19 , pasi mori në shqyrtim **Projekt-Vendimin Nr.157 Datë 17.12.2020** , në mbështetje të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, aktin nr. 09 datë 16.12.2019, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore” dhe aktet nënligjore për zbatim të tij, Vendimin nr. 750, datë 27.11.2019 “Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore në qarqet Durrës, Tiranë dhe Lezhë”, të ndryshuar. Vendim Nr. 904, datë 24.12.2019 “Për përcaktimin e rregullave, të kategorive prioritare, masës së përfitimit, autoriteteve përgjegjëse dhe procedurave për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfutjesve nga disa programe të procesit të rindërtimit”, Vendim Nr.5, datë 06.01.2020 i ndryshuar “Për përcaktimin e rregullave dhe procedurave për përfitimet nga programi i granteve të rindërtimit dhe projektet model”, Vendim Nr.8, datë 06.01.2020 “Për përcaktimin e kushteve dhe të kriterëve të përfitimit të sipërfaqeve ndërtimore në objektet e reja për banim nga subjektet që posedojnë ndërtime të klasifikuara si ndërtime pa leje”, Vendim Nr. 887, datë 24.12.2019 “Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurës së përshpejtuar për hartimin dhe miratimin e planit të detyruar vendor, si dhe procedurës së miratimit të zhvillimit/ndërtimit, në rastet e fatkeqësisë natyrore”. Vendim Nr.22, datë 13.02.2020, të Këshillit Bashkiak Kamëz “Për miratimin e manualit të procedurave për përfitimin nga programet e rindërtimit” Urdhërit nr. 632 datë 18.12.2020 “Për ngritjen e komisionit të përcaktimit të rindërtimit për aplikuesit në lagjen 1 dhe lagjen 2 Kamëz sipas listës bashkangjitur, Urdhërit nr. 617 datë datë 11.12.2020 Për ngritjen e komisionit të përcaktimit të rindërtimit për aplikuesit në Njësinë Administrative Paskuqan sipas listës bashkangjitur, si dhe urdhërit nr. 616 datë 11.12.2020 Për ngritjen e komisionit të përcaktimit të rindërtimit për aplikuesit në lagjen bathore, sipas listës bashkangjitur, **Këshilli Bashkiak Kamëz :**

VENDOSI:

1. Miratimin për një shtese në listën e Vendimit Nr. 149 Datë 07.12.2020 në listën e subjekteve përfitues, të cilët plotësojnë kriteret ligjore për të përfituar nga grantet e rindërtimit për masën e dëmtimeve sipas DS-ve:

- DS1 - Nivel dëmtimi lehtë;
- DS2 - Nivel dëmtimi mesatar;
- DS3 - Nivel dëmtimi serioze;
-

2. Miratimin për vlerën në lekë hartuar nga Komisioni Teknik sipas urdhërit të Kryetarit të Bashkisë Nr. 155 datë 24.02.2020 për përcaktimin e vlerës së grantit të rindërtimit sipas nivelit të dëmtimeve nga tërmeti.

Relacioni u dorëzua pranë Komisionit të Posaçëm me Nr.3784 prot datë 26.05.2020 dhe si më poshtë vijon:

DS-1 përfiton grantin me vlerë 90,154 (nëntëdhjetë mijë e njëqind e pesëdhjetë e katër lekë)

DS-2 përfiton grantin me vlerë 230,060 (dyqind e tridhjetëmijë e gjashtedhjetë lekë)

DS-3 përfiton grantin me vlerë 450,062 (katërqind e pesëdhjetëmijë e gjashtedhjetë e dy lekë)

3. Lista e subjekteve shtesë përfitues e përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi, paraqitet në aneksin bashkëlidhur dhe është pjesë e këtij vendimi.

4. Ky vendim hyn në fuqi pas konfirmimit ligjor nga Prefekti i Qarkut Tiranë.

KRYETARE
MERITA PRENGA

